

VIT POZITIV, PAVARËSISHT SFIDAVE TË MËDHA

Viti 2022 ishte pozitiv për Credins Bank, edhe duke pasur parasysh sfidat makroekonomike dhe kërkesat e shtuara rregullore. Maltin Korkuti, Drejtor i Përgjithshëm i Credins Bank, thotë se viti i kaluar ishte mjaft sfidues për tregjet financiare, me luhajtje të paprecedenta si në normat e interesit, por edhe në kurset e këmbimit, dy nga faktorët më të rëndësishëm makroekonomikë që ndikojnë drejtpërdrejt veprimtarinë financiare të bankave. Sipas tij, një faktor tjetër me ndikim të konsiderueshëm në aktivitetin e bankave kanë qenë kërkesat e shtuara rregullore, të lidhura me shtesat makroprudenciale të kapitalit, por edhe me kërkesat e ndërmjetme të ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Ai nënvizon se faktorët rregullatorë sigurojnë qëndrueshmërinë në kohë të sistemit financiar, por, nga ana tjetër, edhe frenojnë rritjen e tij. Pavarësisht këtyre faktorëve, ai shprehet se Credins Bank ka vijuar të mbajë ritmin e tregut dhe është konfirmuar edhe në 2022 si banka më e madhe kredituese e ekonomisë, ndërsa ka ruajtur pozicionimin si banka e dytë më e madhe për nga vlera e aktiveve dhe e depozitave.

Si do ta vlerësonit ecurinë e Credins Bank vitin e kaluar? Cilat ishin zhvillimet më të rëndësishme në bankën tuaj dhe më gjerë në aktivitetin e sistemit bankar shqiptar?

Ecuria e Bankës Credins gjatë 2022 ka qenë pozitive. Si një bankë që vazhdon të ketë pozita solide në treg dhe si banka e dytë më e madhe në total asetesh dhe në total depozitash, Banka Credins është përballur me sukses me sfidat ekonomike dhe ato rregullore, duke



MALTIN KORKUTI

Drejtor i Përgjithshëm i Credins Bank

pasur parasysh faktin që banka jonë mbështetet në kapitalin vendas edhe në njohuri të profesionistëve që punojnë me ne prej shumë vitesh. Tregu bankar shqiptar në tërësi, edhe pse viti 2022 ka qenë mjaft sfidues për industrinë bankare, ka vijuar të rritet (5% në total asete, ashtu edhe në total llogaritë e klientëve dhe 7% në kreditdhënie). Credins Bank, në vitin 2022, vijoi të ketë një pjesë tregu prej 15.9% në total asete dhe 16.86% në total llogaritë e klientëve, duke mbajtur ritmin e rritjes së tregut në total. Viti 2022 ka qenë mjaft sfidues në fakt për tregjet financiare me luhajtje të paprecedenta, si në normat e interesit,

ashtu edhe në kurset e këmbimit, dy nga faktorët më të rëndësishëm në treguesit makroekonomikë që ndikojnë drejtpërdrejt veprimtarinë financiare të bankave. Më tej, viti 2022, pavarësisht situatës së luhatshme makroekonomike, ka parashtruar kërkesa të shtuara rregullore, si për shtesat makroprudenciale, ashtu edhe për kërkesat e ndërmjetme të ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Këtu duhet të kemi parasysh se aq sa faktorët rregullatorë sigurojnë qëndrueshmërinë në kohë të sistemit financiar, aq edhe frenojnë rritjen e tij, prandaj në këtë kontekst, ne e shohim performancën e bankës sonë gjatë këtij viti të suksesshme.

Nga ana tjetër, ne kemi vijuar të mbështesim ekonominë vendase, duke qenë banka e parë në treg në terma të kreditdhënies me një pjesë tregu prej 19%. Mbështetja që ne u japim individëve dhe bizneseve ka qenë e vazhdueshme përgjatë rrugëtimit tonë prej 20 vitesh në tregun bankar shqiptar. Do të vijojmë të jemi partneri kryesor, duke mbështetur çdo kërkesë dhe nevojë me produkte atraktive, procedura efikase dhe shërbim të shkëlqyer. Strategjia e Bankës Credins për rritje dhe zhvillim të mëtejshëm në tregun bankar shqiptar, u shoqërua me shumë nisma të bukura në mbështetje të zhvillimit të përgjithshëm të shoqërisë shqiptare. Më shumë se 140 aktivitete, në linjë me 17 objektivat për zhvillim të qëndrueshëm, na rendisin një korporatë lider në treg për përgjegjshmërinë tonë, për të qenë afër shtresave në nevojë, luftës ndaj varfërisë, përmirësimit të vazhdueshëm të infrastrukturës së institucioneve, ndikimit pozitiv në mjedis etj. Ndërkohë, sistemi bankar shqiptar ka përballuar me sukses implementimin e një sërë reformash, ku bankat kanë qenë pjesë integrale e lehtësimit të proceseve, siç ka qenë reforma e fiskalizimit, e cila u konsolidua më tej në vitin 2022. Bankat kanë kontribuar masivisht me burimet e tyre, në plotësimin e kërkesave për infrastrukturën e nevojshme në këtë drejtim. Dixhitalizimi i mëtejshëm i kryerjes së pagesave nga popullata dhe investimet e vazhdueshme të bankave për të rritur aksesin në sistemin bankar të popullatës kanë qenë nga angazhimet kryesore si nga ana financiare, ashtu edhe teknike e profesionale, me të cilat jemi përballur.

Vitin e kaluar, ekonomia u përball me inflacionin më të lartë në dy dekada dhe me rritje të shpejtë të normave të interesit. Si u reflektuan këto zhvillime në ecurinë e sektorit bankar?

Konflikti në Ukrainë përshpejtoi në mënyrë të paprecedentë rritjen e normave të interesit, pavarësisht se sinjalet për ardhjen e mundshme të

një cikli ekonomik me rritje të normave të interesit, pas disa viteve ku politika monetare globale në tërësi kishte qenë lehtësuese për ekonominë, sidomos në kushtet e pandemisë së COVID-19, ishin paraprirë nga tregjet financiare. Këto lloj ngjarjesh nuk mund të përballohen të vetëm nga aktorët e tregjeve financiare, por kërkojnë bashkërendim të veprimeve të ndërmarra nga

rregullatori dhe të gjitha institucionet financiare. Pikërisht kjo ndodhi edhe në tregun shqiptar. Sigurisht, që lëvizje të tilla të menjëherëshme nuk mund të kalojnë pa u ndier nga sektori bankar dhe pa cenuar përfitueshmërinë, por ajo që ne jemi përpjekur të bëjmë është minimizimi ndaj ekspozimeve me rreziqe të shtuara, në kushtet e paqartësive për ecurinë e kthimeve nga investimet. Gjithsesi, sistemi bankar shqiptar është ende shumë i lidhur me ekonominë reale, duke paraqitur oportunitete. Ne kemi vijuar mbështetjen e ekonomisë me kreditim dhe në të njëjtën kohë dhe menaxhimin sa më të kujdesshëm në investimet në instrumente financiare. Nga ana tjetër, kemi vijuar të shpërblejmë besnikërinë e klientëve tanë, duke paraqitur oferta tërheqëse dhe një mori alternativash për investimin e fondeve të tyre. Vlen të përmendet se, përveç mundësive konkurruese në normat e depozitave, klientët e Bankës Credins kanë prej vitesh mundësinë për të investuar në instrumente borxhi, duke qenë se banka jonë është e para bankë në treg që ka emetuar instrumente të tillë.

Cilat do të jenë objektivat tuaja në vitin 2023 dhe cilat prisni të jenë sfidat kryesore për biznesin e bankave këtë vit?

Objektivi ynë është konsolidimi i mëtejshëm i Bankës Credins si një bankë shqiptare, e cila vazhdimisht është në një hap me zhvillimet teknologjike në botë, në drejtim të modernizimit të veprimtarisë bankare. Investimet në teknologji për të ofruar zgjidhje të reja dhe të shpejta në kanalet dixhitale, duke rritur sigurinë e klientëve drejt përdorimit të aplikacioneve, do të jenë në fokus të vazhdueshëm. Ne synojmë shpërblimin e besnikërisë që klientët tanë na kanë treguar në këto vite jo të lehta për industrinë bankare dhe zgjerimin e bazës së klientelës, duke përmblusur nevojat e tyre që janë në zhvillim të vazhdueshëm. Sfidat kryesore janë realizimi i projekteve të nevojshme në kohë si dhe sigurimi i përputhshmërisë me kërkesat rregullore të të gjitha institucioneve me të cilat lidhet veprimtaria komplekse bankare. Sfidë tjetër do të jetë mbështetja e nevojshme për klientët tanë, në kushtet e kostove të rritura të kredimarrjes dhe në të njëjtën kohë, mbajtja e konkurrueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së bankës. ■

VIZIONI

Ne kemi vijuar të mbështesim ekonominë vendase, duke qenë banka e parë në treg në terma të kreditdhënies me një pjesë tregu prej 19%. Mbështetja që ne u japim individëve dhe bizneseve ka qenë e vazhdueshme përgjatë rrugëtimit tonë prej 20 vitesh në tregun bankar shqiptar. Do të vijojmë të jemi partneri kryesor, duke mbështetur çdo kërkesë dhe nevojë me produkte atraktive, procedura efikase dhe shërbim të shkëlqyer.

